
DOKUMENTE E MATERIALE

TË DHËNA TË REJA RRETH NGJARJEVE TË VITIT 1981 NË KOSOVË NË DOKUMENTET E PK JUGOSLLAVE

Arkivat ballkanike për shek.XX, edhe pse në pamje të parë duket sikur nuk kanë vlerat e arkivave të Shteteve të Mëdha, me interesa në rajon (sikurse ishin dikur Austro-Hungaria, Italia, Gjermania, Britania e Madhe, Rusia dhe Franca), dhe sikurse më pas e deri sot, ishin dhe janë Italia, Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Bashkimi Sovjetik (20 vjetët e fundit Rusia) dhe veçanërisht SHBA) në fakt për historinë kombëtare të shqiptarëve ruajnë vlera të jashtëzakonshme. Fqinjët tokësorë të Shqipërisë Greqia, Serbia dhe Mali i Zi pas vitit 1918, Greqia dhe Mbretëria serbo-kroato-sllvoene, apo Mbretëria Jugosllave (emri zyrtar pas vitit 1929), dhe pas vitit 1945 Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, ose 20 vitet e fundit ish republikat e saj jugore të pavarësuar pas shpërbërjes së Federatës, por edhe shtete të tjerë, pak më larg, posaçërisht Turqia, Bullgaria, Rumania etj., ruajnë në arkivat e tyre një pasuri të çmuar dokumentare, në mjaft raste me vlera të papërsëritshme. Fqinji, për mirë a për keq, të njeh e vlerëson me dhëmbë e dhëmballë, sikurse edhe ti atë, ndaj detajet e marrëdhënieve bilaterale e më gjerë, të ngjarjeve të ndryshme, evidentimi e portretizimi i personaliteteve të rangjeve të ndryshme, ndriçohen nga një kënd origjinal. Aq më tepër përfshirja e pakicave nacionale brenda kufijve të shteteve fqinje (në rastin e fqinjëve veriorë do të duhej thënë përfshirja e shumicave nacionale, sepse ka qenë fjala për gati gjysmën e kombit shqiptar) ka prodhuar dokumente specifike që japin dorë për trajtime të veçanta, demografike, politike, sociale, ekonomike, kulturore, arsimore etj.

Materiali arkivor i akumuluar dhe sistemuar gjatë shek.XX në arkivat e Serbisë, Malit të Zi, më pas Jugosllavisë (Mbretëri apo Republikë Federative) dhe shteteve të pavarura që lindën pas shpërbërjes së saj, përkatësisht arkivat e Beogradit, Cetinës, Prishtinës, Shkupit etj., përbëjnë kështu një pasuri të begatë, që ka filluar të shfrytëzohet edhe nga studiuesit tanë.

Ndër dokumentet e arkivave jugosllave të gjysmës së dytë të shek. një rol për ndriçimin e ngjarjeve përgjithësisht, dhe të atyre që lidhen me shqiptarët e Kosovës e më gjerë, janë dokumentet e administratës shtetërore dhe organeve partiake krahinore, republikane e federative. Një dokument të tillë përfaqëson edhe Raporti i titulluar **“Informata për demonstratat armiqësore në krahinë, më 11, 25 e 26 mars dhe më 1, 2 3 prill 1981”**, që u përgatit nga *Kryesia e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës* në maj

1981, d.m.th. rreth 1 muaj pas ngjarjeve. Ky dokument i depozituar në Arkivin Shtetëror të Maqedonisë në Shkup, me sa duket është bërë i njohur ndër autoritetet e kohës në nivele federative e republikane, por ka indikacione që gjendet edhe në Arkivin Shtetëror të Kosovës. Raporti i kushtohet tërësisht ngjarjeve të njohura të vitit 1981.

Çfarë ndodhi në vitin 1981 në Kosovë? Kush i nxiti protestat e shqiptarëve dhe si agravano ato? Çfarë u kërkua nga protestuesit dhe si reagoan autoritetet lokale, republikane e federative?

Këto shumë e shumë pyetje të tjera janë shtruar e shtrohen ende sot. Por ndërsa përgjigjet për shumë pyetje ekzistojnë dhe nuk kanë pasur kontestime, p.sh. për pyetjet lidhur me kronologjinë e ngjarjeve, qytetet ku u zhvilluan manifestimet, për kërkesat e paraqitura etj., për pyetjet e tjera ende nuk ka një përgjigje të vetme. Diskutohet ende për numrin e demonstruesve, për numrin e të vrarëve e të plagosurve ndër ta dhe nga radhët e forcave të rendit, për organizatorët dhe ata që u prinë studentëve e punëtorëve në rrugë e sheshe, për shkaqet e shpërthimit etj. Dikush i ka vlerësuar ngjarjet e 1981 si demonstrata, e ky është vlerësimi më i përhapur (kështu vlerësohet edhe në raportin kryesisë së Komitetit Krahinor të LKJ. Kështu u quajtën dhe në Tiranë), disa i kanë quajtur revolta, e ndonjë ish pjesëmarrës i konsideron revolucion. Diskutimet e kontestimet janë shtuar kur bëhet fjalë se çfarë ishin zhvillimet e vitit 1981 dhe kush i nxiti. Raporti tregon se për elitën politike krahinore, administrative e partiake ngjarjet e vitit 1981 ishin *“demonstrata armiqësore”*, *“të dëmshme politikisht dhe të patolerueshme”* të cilat, ndonëse *“shkas patën gjoja pakënaqësinë e një grupi studentësh, për shkak të ushqimit, pritjes së gjatë, shërbimit jo efikas etj. ... në restorantin e studentëve ...”*, në fakt *“ishin shprehje e forcave armiqësore e nacionaliste”* *“për krijimin e trazirave dhe të pastabilitetit në Kosovë”* dhe *“në tërësi janë pjesë përbërëse e tendencave armiqësore, të orientuara kah destabilizimi dhe shkatërrimi i Jugosllavisë”*.

Përgjigje të ndryshme ka marrë edhe pyetja se kush i organizoi dhe i nxiti shqiptarët të dalin në rrugë. Thënë në mënyrë figurative, eshka vërtet ishte e thatë, po kush ia futi xixën?

Vallë organizatat ilegale patriotike? Apo shërbimet shqiptare të inteligjencës? Ishte shërbimi informativ serb që kërkonte shkak për represion e goditje mbi shqiptarët pas vdekjes së Titos, sa kohë që shqiptarët s’kishin mundësi të frenonin revanshin serb, kurse udhëheqjet e njësisve të federatës nuk mund të pengonin realisht, sepse kishin filluar të mbylleshin në guaskat nacionale të republikave respektive të Federatës? Apo i nxiti fillimisht vetë *udhëheqja krahinore*, elemente të së cilës kishin motivime të ndryshme, që nga dëshira për të marrë të drejta më të mëdha për KSAK, duke e kthyer statusin e saj në republikë, e deri te qëndrime klienteliste në shërbim të tjetërkujt.

Nuk kanë munguar edhe prononcimet që i kanë quajtur ngjarjet krejt spontane, e deri të tilla që e kanë quajtur gjithçka kryesisht lojë të konfrontimit

në rajon të shërbimeve të inteligjencies së superfuqive, përkatësisht të KBG dhe CIA-s etj.

Raporti është hartuar shumë shpejt pas ngjarjeve të mars-prillit 1981, kur shumëçka ende nuk ishte kthjelluar, apo siç ndodhte rëndom, me shtetet e lindjes, në një kohë kur dukshëm raportohej siç do të dëshironte qendra, apo nevoja e hartuesve për t'u shfajësuar e vetëmbrojtur.

Në raportin që kemi në duar nuk ka akuza ndaj Tiranës zyrtare. Për sa kohë nga Shqipëria reagimi verbal ishte relativisht i vakët, por ndoshta edhe për motive të tjera, në fazën që u shkrua raporti, edhe pse përmenden "*forcat armiqësore ... e nacionaliste*", ndaj saj nuk u hodhën akuza në mënyrë të artikuluar, sikurse do të ndodhte më pas. Gjithsesi, pyetja se sa dhe si ndikoi Shqipëria në ngjarjet në fjalë mbetet ende e shtruar.

Raporti trajton në detaje me ditë e me orë, duke filluar nga ora 19⁰⁰ e 11 marsit, zhvillimin e "*trazirave*", praninë, siç thuhet në raport, e "*provokatorëve*", parullat që u përdorën në fillim e më pas (të cilat nga sociale e ekonomike u shndërruan në politike, deri te kërkesa "Kosova Republikë", "Republikë e kushtetutë ja me paqe, ja me luftë", "Bashkimi i viseve shqiptare", "Jemi shqiptarë e jo jugosllavë", "Kosova është e jona", etj.), impenjimi dhe reagimin e autoriteteve me punë politike e me përdorimin e forcave të rendit (të organizuara e riorganizuara posaçërisht me këtë rast, mandej me përdorimin deri të gazit lotsjellës e të armëve, deri të tankeve, për shpërndarjen e protestuesve.

Raporti ka tendencën të tregojë se autoritetet krahinore kishin punuar mirë, se ato situatën e kishin pasur nën kontroll, edhe pse pranojnë se shpërthimi i protestave i kapi në befasi. Në raport duket se bëhen përpjekje për të minimizuar pjesëmarrjen në protesta dhe për të fajësuar një numër sa më të kufizuar njerëzish, për të justifikuar, madje për të vlerësuar qëndrimin e stafit akademik të UP, por në raport nuk mund të mos pohohet se përplasjet ishin shumë të dhunshme dhe se pati të vrarë, shumë të plagosur, dhe një numër të konsiderueshëm të arrestuarish (qysh më 12 mars organet e rendit kishin identifikuar *si organizatorë të drejtpërdrejtë* (pra koka e organizimit nuk merret përsipër të evidentohet) e demonstrues agresivë 102 studentë, prej të cilëve 79 nga Kosova dhe 23 nga viset e tjera shqiptare në Jugosllavi. Bilanci përfundimtar i raportuar ishte 8 demonstrues të vrarë e 130 të plagosur, si edhe 1 milic i vrarë dhe 135 të plagosur. Kurse dëmet materiale llogariteshin rreth 9 milion dinarë. Deri në formulimin e raportit, pra, deri në muajin e vitit 1981, figuronin edhe 956 të proceduar, 219 të dënuar për kundravajtje dhe 45 në procedura të ndjekjes penale. Më pas shifrat do të shtoheshin dukshëm dhe pasojat ose së paku "bisedat informative" pranë organeve të specializuara, në vitet në vijim do të preknin gati gjithë popullsinë shqiptare në moshë madhore. Nën ndikimin e Beogradit, e në shërbim të spastrimeve në Kosovë dihet se në

periudhën që pasoi, “gjuetia e shtrigave”, kërkoi fajtorë në çdo familje shqiptare ...

Në raport nënvizohet se gjatë gjithë kohës së zhvillimit të ngjarjeve Kryesia e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës kishte “lidhje permanente, informim reciprok dhe marrëveshje me Kryesinë e RSF të Jugosllavisë, me Kryesinë e KQ të LK të Jugosllavisë dhe me Këshillin Ekzekutiv Federativ, si dhe me udhëheqësin e RS të Serbisë, kurse sekretariati krahinor i Punëve të Brendshme me sekretariatën Federativ dhe me atë Republikan të Punëve të Brendshme”. Ky komunikim i vërtetë në vetvete nuk e shpëtoi elitën politike të Kosovës nga likuidimi politik, veçanërisht pjesën shqiptare të saj, menjëherë pas ngjarjeve.

Gjithsesi, Kryesia e Komitetit Krahinor të LK dhe Kryesia e KSA të Kosovës bëri çka mund të bënte për t’i shpëtuar ndëshkimit të pritshëm. Në raport shënohet se ato “konstatuan se është domosdoshme që të shpejtohet analizimi i tërësishëm i burimeve të prapavijë dhe i forcave nga *radhët e armiqve të brendshëm e të jashtëm*, që qëndrojnë prapa këtyre aksioneve”. “Fill pas kësaj të gjithë organizatat themelore të LK u informuan për *karakterin armiqtësor të këtyre ngjarjeve*” Partia shtet po hynte në veprim kundër aspiratave të shqiptarëve duke vijuar koncesionet ndaj nacionalizmit serb, Demonstrimi ditët e prillit me flamurin e Jugosllavisë, krahas atij shqiptar, me fotografinë e Titos dhe me parullën “Tito-Partia”, (me sa duket të përdorura nga protestuesit për mbrojtje përballë etiketimeve të protestave si veprime “armiqësore e nacionaliste”), nuk luajtën asnjë rol për të vlerësuar jo armiqtësore veprimet e shqiptarëve.

Të dhënat e raportit gërshetuar me ato të dhëna të tjera, veçanërisht të viteve që pasuan, tregojnë se Jugosllavisë së Titos i kishte ardhur fundi. Elitat politike të kombeve e kombësive të Jugosllavisë po tkurrehin në mbrojtje të interesave nacionale në guaskën e republikave respektive, kurse Kosova dorës po vlerësohej si kurban i duhej falur Serbisë, në shkëmbim të paqes specifike, artificiale e të përkohshme, dhe të largimit nga vetja të goditjes së revanshizmit të Serbisë. Ngjarjet e 1981 në Kosovë ishin, sikurse del qartë nga raporti për të cilën referuam sot, preludi i shkatërrimit të Federatës Jugosllave. Ky raport i jep përgjigje edhe një varg pyetjesh duke lënë ende hapur trajtimin e një sërë pyetjeve të tjera.

MARENGLLEN VERLI

**INFORMATA PËR DEMONSTRUESIT ARMIQËSORË NË KRAHINË
MË 25 E 26 MARS DHE MË 1, 2 E 3 PRILL 1981,
PRISHTINË, MAJ 1981***

Më 11 mars të vitit 1981, rreth orës 10.00 në Menzën e Studentëve në Prishtinë ndodhi një shkelje e rëndë e rendit publik dhe qetësisë, e pastaj shpërthyen demonstrata të një numri të konsiderueshëm studentësh, të cilët ushqehen në restorantin e studentëve. Shkas i drejtpërdrejtë i këtyre trazirave ishte, gjoja pakënaqësia e një grupi studentësh për shkak të ushqimit, pritjes së gjatë, shërbimit jo efikas, dritës së dobët etj. Pas kësaj, grupi i përmendur doli jashtë Restorantit, u tubua para Restorantit dhe u drejtua nëpër rrugën “Ramiz Sadiku” në drejtim të Fakultetit Teknik. Në atë kohë ishin në grup rreth 200-400 studentë, të cilët i ndalnin veturat dhe automjetet e tjera dhe u bënë dëme relativisht të vogla.

Ndërsa ishte duke ecur në rrugët “Ramiz Sadiku” dhe “Marshalli Tito”, këtij grupi iu bashkuan edhe nja 100 studentë të tjerë. Me të ecur prej Kuvendit të KSA të Kosovës e deri te ndërtesa e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, demonstrantët lëshonin njëzëri parulla në gjuhën shqipe “kushte”, kurse para ndërtesës së Komitetit Krahinor të LK të Kosovës edhe “ushqimi”. Më atë kohë, si zakonisht, në korzo para ndërtesës së Fakultetit Krahinor të LK të Kosovës ishin shumë shëtitës, kryesisht njerëz të rinj, studentë dhe nxënës të shkollave të mesme, të cilët nuk iu bashkuan demonstrantëve.

Në ndërkohë, një grup aktivistësh të Komitetit Komunal të LK të Prishtinës, të Komitetit Krahinor të LK të Kosovës dhe të Universitetit hyjnë në radhët e studentëve me qëllim që me mjete politike, me veprim ideopolitik t'i bindnin studentët që të shpërndahen, të kthehen në Qendrën e Studentëve dhe atje të bisedojnë konkretisht në lidhje me kërkesat për përmirësimin e kushteve dhe të standardit të studentëve përgjithësisht. Pas bisedave që zgjatën gati një orë, studentët u pajtuan që të shkojnë deri në Menzë të studentëve dhe atje të bisedojnë. Në të ecur deri në Qendrën e Studentëve, grupi ecte ngadalë, ndalej shpesh, këndonte, e kohë pas kohe përsëriste parullat “Kushtet” dhe “Ushqimi”.

Një grup tjetër studentësh – afro 200 sish arritën të organizohen dhe të nisen nëpër rrugën “Ramiz Sadiku” në drejtim të qytetit, duke lëshuar parulla “i duam shokët”, por forcave të sigurimit u shkoi për dore t'i pengojnë në këtë drejtim. Kur në radhët e studentëve të tubuar u përhap dezinformata se një

* Arkivi Shtetëror i Kosovës (ASHK), Fondi: Komiteti Krahinor i LK të Kosovës, Kutia 306, fondi i papërpunuar, viti 1981.

numër i tyre ishin arrestuar, pjesëmarrësit filluan të lëshojnë gjithnjë e më shpesh dhe me zë më të lartë parulla në gjuhën shqipe: “kërkojmë kushte më të mira”, “duam vepra e jo fjalë”, “dikush në fotela, e dikush pa bukë”, “deri kur në podrume”?, “poshtë borgjezia”, dhe “lironi shokët tanë”. Pas orës 22⁰⁰ grupet u takuan para menzës. Pjesëmarrësve të demonstratave u folën 3 studentë, të cilët - duke kërkuar prej tyre disiplinë – theksuan se qëllim i tubimit të tyre është të kërkojnë të drejta dhe përmirësim të kushteve të jetës dhe të punës, e jo të çrregullojnë rendin publik dhe qetësinë. Mirëpo, ata njëkohësisht i ftuan demonstrantët që të mbesin të tubuar dhe të jenë kompaktë në mbrojtjen e kërkesave të veta. Pas kthimit afër menzës së studentëve, duke u tubuar rrugës, u tubuan afro 2.000 sish, ku edhe u bllokuan në një hapësirë relativisht të ngushtë nga ana e pjesëtarëve të forcave të sigurimit.

Me studentët e tubuar, numri i të cilëve ishte shtuar, u orvatën të bisedojnë prorektori dhe profesorët e Universitetit të Kosovës, nënkryetari i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës e të tjerë, por të gjithë këta u përcollën me britma. Megjithë këtë, një numër studentësh u ndanë dhe u kthyen në konvikt. Atmosfera u ashpërsua edhe më shumë me parullën “i duam shokët”, me çka praktikisht u bë e pamundshme çdo bisedë e mëtejshme, aq më parë me ata që bërtitnin më së shumti.

Megjithëse pjesa më e madhe e studentëve qëndronin në mënyrë pasive, ata më “luftarakët” dhe më të kumbueshëm i gjuanin gjithnjë me gurë pjesëtarët e shërbimit të sigurimit, të cilët qëndronin në një distancë prej 50 metra.

Kah ora 01 të 12 marsit, të revoltuar nga bllokada e pjesëtarëve të organeve të sigurimit, demonstrantët duke gjuajtur me gurë tentuan ta lirojnë kalimin në drejtim të qytetit. Meqenëse ishin shterrë të gjitha mjetet politike, me vendim të Komitetit të Mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe të vetëmbrojtjes Shoqërore të KSA të Kosovës, forcat e sigurimit, me përdorimin e mjeteve kimike- të gazit lotsjellës – në orën 02.30 e shpërndanë grupin, prej të cilit u ndanë nja 50 studentë duke u tubuar përsëri në terrenin midis konvikteve të studentëve, duke lëshuar parulla dhe duke kënduar deri në orën 0,5 kur edhe ky grup u shpërnda definitivisht me intervenim të mëvonshëm të forcave të sigurimit.

Gjatë demonstratave dhe me rastin e intervenimit të forcave të sigurimit nuk u lëndua rëndë asnjë student, kurse demonstrantët lënduan rëndë dy milicionarë – njërin me revole kurse tjetrin me gurë, e 18 të tjerë u lënduan lehtë.

Organet e punëve të brendshme, në marrëveshje me Komitetin e Mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe të vetëmbrojtjes Shoqërore të KSA të Kosovës, iu përveshën identifikimit të organizatorëve, të pjesëmarrësve më ekstremë dhe më të kumbueshëm. U identifikuan gjithsej 102 vetë, prej të cilëve 79 nga Kosova, kurse 23 studentë jashtë krahinës.

Në Prishtinë ishin të angazhuara ekskluzivisht forcat e sigurimit nga KSA e Kosovës, kurse organet e punëve të brendshme u vunë në gjendje mobilizimi. Në bazë të autorizimeve ligjore, sekretari krahinor i punëve të brendshme, me vendim të 11 marsit, formoi një njësi të veçantë të milicisë, të përbërë ekskluzivisht prej njerëzve të organeve nga territori i Kosovës.

Kryesia e KSA të Kosovës, Kryesia e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës, si dhe organet dhe udhëheqësit e komunës së Prishtinës, ishin të tubuara që nga fillimi i demonstratave e përcillnin dhe e vlerësonin situatën, orientonin dhe ndërmerrnin masa për tejkalimin e situatës së krijuar. Organet e punëve të brendshme dhe faktorët e tjerë të vetëmbrojtjes ishin të angazhuara që nga fillimi për sigurimin e rendit publik dhe të qetësisë, të objekteve me rëndësi vitale dhe merrnin pjesë në ndërmarrjen efikase të demonstratave.

Komiteti i Mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe i vetëmbrojtjes Shoqërore ishte në tubim permanent, merrte vendime, i orientonte dhe koordinonte drejtpërdrejtë të gjitha masat dhe aksionet politike dhe ato të sigurisë të organeve me qëllim që të ndërprehej dhe të tejkalohet me sukses situata e krijuar.

Në të gjitha komitetet komunale të Lidhjes së Komunistëve në krahinë gjatë natës u aplikua syçeltësia më e madhe dhe mobilizimi dhe sigurohej informimi permanent për ngjarjet.

Më 12 prill në mëngjes, në mbledhjen e përbashkët të kryesisë së KSA të Kosovës dhe të kryesisë së Komitetit Krahinor të LK të Kosovës u dha një informatë e gjerë dhe u bë kualifikimi themelor i këtyre ngjarjeve, i organizimit dhe veprimit tonë të tërësishëm për ndërprerjen e trazirave për senimin e gjendjes.

Megjithëse përkrah shkasi i tyre i drejtpërdrejtë dhe përkrah parullat e tyre kishin karakter social dhe ishin të lidhura për kushtet e ushqimit të studentëve dhe më gjerë, për disa çështje të standardit të studentëve, këto demonstrata të studentëve – përkrah dimensionit të tyre, përkrah koha mënyra e artikulimit dhe përkrah pasojat - ishin aksion jashtëzakonisht i dukshëm politik, i patolerueshëm dhe i palejueshëm në sistemin tonë. Mënyra e tillë e artikulimit të problemeve sociale - edhe atëherë kur këto probleme realisht ekzistojnë – nuk i ndihmon zgjidhjes së suksesshme të problemeve, e mund të jetë i dobishëm dhe në funksion vetëm të shprehjes së forcave dhe të tendencave armiqësore e nacionaliste.

Këto ngjarjen Qendrën e Studentëve i karakterizon elementi i befasisë, meqenëse nuk ekzistonin kurrfarë indicionesh se po përgatiteshin ngjarje të tilla dhe përfshirja e studentëve në demonstrata pas sjelljeve brutale të një grupi të vogël studentësh gjatë darkës në restorantin e studentëve. Kjo njëkohësisht, e vë në dukje organizimin e dobët të vetëmbrojtjes në Qendrën e studentëve.

Demonstrantëve nuk u shkoi për dore t'i bëjnë për veti pjesën më të madhe të rinisë studenteske - abonentë të restorantit dhe banues të Qendrës së studentëve, e sa të rinjtë dhe qytetarët e tjerë të cilët i përcillnin këto ngjarje.

Që nga fillimi i demonstratave, në Komitetin e Mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe të vetëmbrojtjes shoqërore të KSA të Kosovës ishte konkretizuar edhe plani i aplikimit eventual të forcës dhe rendi i veprimeve graduale. Në bazë të qëndrimit të Komitetit të Mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe të vetëmbrojtjes Shoqërore, që nga fillimi i demonstratave u ndërmorën masa për përqendrim të disa njësisë të milicisë në Prishtinë, për mobilizim të njësisë rezervë të milicisë, për vënien e disa shtabeve të mbrojtjes territoriale dhe të një njësie speciale me gjendje gatishmërie, e sidomos masat për sigurimin e objekteve vitale.

Në mbledhjen e të dy kryesive, - krahas vlerësimit dhe kualifikimit të ngjarjeve dhe nxjerrjes së disa përvojave për organizimin tonë më të mirë në lëmin e sigurisë dhe të vetëmbrojtjes - u caktuan, ara së gjithash, detyrat e drejtpërdrejta ideopolitike në lidhje me sanimin e gjendjes, me vazhdimin e punës normale, të mësimave dhe të jetës në Universitet, me informimin e ngutshëm të drejtë të komunistëve dhe të punonjësve në Prishtinë dhe më gjerë në Krahinë për ngjarjet, me ndërmarrjen e masave të syçeltësisë dhe të organizimit më të mirë në çdo ambient me qëllim që të pengohet çfarëdo aksesit apo trazimi, për të tubuar rreth politikës së Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë numrin më të madh të studentëve, të rinisë, të punëtorëve dhe të punonjësve, për dënimin energjik të këtyre demonstratave, por edhe për pengimin e çdo forme të dramatizimit, të predimensionimit dhe të spekulimeve, të studentëve e përgjithësisht, të ndonjë kombi, për pengimin e ngjalljes së nacionalizmit shqiptar apo serb e të tjera.

Më 12 mars në orën 03 u mbajt mbledhja e zgjeruar e Komitetit Komunal të Mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe të vetëmbrojtjes Shoqërore, ku u vlerësua gjendja politike dhe e sigurisë dhe u caktuan masat dhe aktivitetet e mëtejshme. Në të njëjtën kohë, në Rektoratin e Universitetit të Kosovës u mbajt mbledhja me të gjithë sekretarët e organizatave themelore të Lidhjes së Komunistëve të fakulteteve dhe të Qendrës së Studentëve, me kryetarët e konferencave aksionare të fakulteteve, me dekanët dhe me kuadrot e tjerë, ku u analizua gjendja e tërësishme në Universitet dhe në Qendrën e Studentëve dhe u caktuan masat e mëtejshme për zhvillimin normal të mësimave.

Në mëngjes (më 12 mars), komitetet e mbrojtjes së përgjithshme popullore dhe të vetëmbrojtjes shoqërore në të gjitha komunat shqyrtuan situatën aktuale politike e të sigurisë, kurse në të gjitha qendrat - me pjesëmarrjen e kuadrove nga komunat fqinje u mbajtën mbledhjet e zgjeruara të komiteteve komunale të Lidhjes së Komunistëve (me pjesëmarrjen e kuadrove nga Krahina), ku u dhanë informata dhe vlerësime lidhur me ngjarjet në Qendrën e Studentëve dhe u caktuan detyrat e drejtpërdrejta në angazhimin e mëtejshëm politik.

Në bazë të konkluzioneve të mbledhjes së përbashkët të Kryesisë së KSA të Kosovës dhe të Kryesisë së Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, Komiteti Krahinor u informua - në mbledhjen që mbajti më 11 mars – për kualifikimin themelor të këtyre ngjarjeve, si dhe për masat që ishin ndërmarrë me qëllim të ndërprerjes së trazirave dhe të sanimit të gjendjes. Komiteti Krahinor i LK të Kosovës e aprovoi Informatën, si dhe kualifikimin themelor të cilin e kishin dhënë në lidhje me demonstratat e 11 marsit Kryesia e KSA të Kosovës dhe Kryesia e Komitetit Krahinor të Lidhjes së komunistëve të Kosovës.

Gjatë gjithë kohës së këtyre ngjarjeve, Kryesia e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës kishte lidhje permanente, informim reciprok dhe marrëveshje me Kryesinë e RSF të Jugosllavisë, me Kryesinë e KQ të LK të Jugosllavisë dhe me Këshillin Ekzekutiv Federativ, si dhe me udhëheqësin e RS të Serbisë, kurse Sekretariati Krahinor i Punëve të Brendshme - me Sekretariatit Federativ dhe me atë Republikan të Punëve të Brendshme.

* * *

Më 25 mars 1981 kah ora 11.50 në oborrin e përbashkët të Shkollës së lartë Pedagogjike dhe të Akademisë Pedagogjike në Prizren erdhi një grup prej 20 deri 30 nxënësish të shkollave të mesme dhe studentësh dhe hyri në ndërtesë të Shkollës së lartë Pedagogjike, duke lëshuar parulla (në gjuhën shqipe). “Kushtet”. Me atë rast ky grup theu dy dritare në ndërtesën e shkollës. Studentët e Shkollës së lartë Pedagogjike gjendeshin në atë kohë në mësim dhe asnjëri prej tyre nuk iu bashkua. Pas kësaj, ky grup u nis në drejtim të Akademisë pedagogjike, por nuk i shkoi për dore të hyjë në ndërtesë, kështu që vazhdoi kah gjimnazi, në të cilin edhe hyri, por as këtu nuk iu bashkua kurrkush. Grupi doli prej ndërtesës së gjimnazit dhe u nis në drejtim të Shkollës së Medicinës dhe të Konviktit të Studentëve. Meqenëse as atje nuk iu bashkua kurrkush, grupi u nis në drejtim të Qendrës së qytetit, kurse rreth orës 12.20 u shpërnda plotësisht në saje të intervenimit të organeve të sigurimit publik – kryesisht pa përdorim të forcës fizike. Gjatë gjithë kohës së kalimit nëpër qytet, grupit nuk iu bashkua kurrkush. Ky grup, duke ecur rrugëve, theu nga një dritare në tetë shitore, një qelq në një automjet, kurse nuk iu bashkuan, por reagan haptas dhe i dënuan veprimet e këtilla, kurse disa qytetarë morën pjesë në shpërndarjen e grupit.

Në intervenim u lëndua lehtë një milicionar. Shumica e pjesëmarrësve të këtij grupi janë nxënës të dy shkollave të mesme të Prizrenit, disa nga Shkolla e Lartë Pedagogjike të Prizrenit dhe nga Qendra e Shkollave të mesme të Suharekës.

Komiteti i Mbrojtjes së Përgjithshme popullore dhe i vetëmbrojtjes shoqërore në prizren ishte në tubim permanent, merrte qëndrime, ndërmerre masa dhe koordinonte aktivitetin. Komiteti Komunal i LK në Prizren, me pjesëmarrjen e kuadrove nga Komiteti Krahinor i LK të Kosovës, bëri plan të aktivitetit politik në të gjitha ambientet në Komunë.

* * *

Më 26 mars kah ora 6.00 të mëngjesit, një grup i vogël studentësh bllokoi hyrjet në të tri konviktet e studentëve në Prishtinë, i mbylli dyert, e pengoi daljen dhe kërkoi biseda me personalitete të caktuara të Universitetit dhe me disa funksionarë krahinorë, duke theksuar se – në rast të kundërt – nuk do ta lëshojë askend brenda dhe se do të dalin pasivisht në demonstrata.

Në bazë të disa indicioneve që i kishin gjatë natës së mëparshme për përgatitjen e mundshme të disa trazirave të studentëve, e edhe në kuadër të angazhimit vijues në bazë të programit të aktivitetit që ishte aprovuar pas demonstratave të studentëve nga 11 marsi, një grup aktivistësh të komunës së Prishtinës dhe një numër mësimdhënësish dhe rektori i Universitetit u angazhuan menjëherë, i deblokuan të tri konviktet dhe vepruan në radhët e studentëve të tubuar për t'i larguar nga demonstratat dhe nga incidenti.

Organizatorët e drejtpërdrejtë të demonstratave i ftuan studentët që të dalin në pllantonë para konvikteve të studentëve, ku u tubuan në fillim 400-500 sish, e pak më vonë afro 1.000 studentë. Këtu, ndër studentët, vazhdoi aktiviteti i kuadrove të Universitetit të Prishtinës, të cilave iu bashkuan edhe një numër kuadrosh nga Krahuina. Organizatorët e kësaj trazie - në bazë të përgatitjeve të mëparshme – filluan biseda rreth kushteve të jetës dhe punës së studentëve, duke bërë krahasime me kushtet në qendrat e tjera universitare. Ata paraqitnin kohë pas kohe kërkesën që “të lirohen shokët e tyre prej burgut”. Diku kah ora 8.00 studentët filluan t'i bojkotojnë bisedat. Megjithëkëtë, kuadrot theksonin se për këto probleme duhet biseduar në mënyrë normale, adekuate, por njëkohësisht jepnin shpjegime në lidhje me kushtet e jetës dhe të punës së studentëve, me masat dhe përpjekjet që janë duke u bërë për përmirësimin e standardit dhe theksonin se kurrkush prej shokëve të tyre nuk gjendet në burg.

Kur organizatorët e këtij aksioni “i shterrën” të gjitha temat sociale, për të cilat morën përgjigje prej kuadrove tona, filluan t'i bojkotojnë bisedat dhe të paraqesin çështje të tjera me karakter politik e jo social. Kah ora 12.40 filluan të lëshojnë edhe parulla me përmbajtje armiqësore, duke ngritur një numër transparentesh. Parullat dhe transparentet kishin këtë përmbajtje: “Rroftë marksizëm-leninizmi – poshtë revizionizmi”, “Bashkimi”, “Trepça punon për të tjerët”, “Rroftë klasa punëtore”, “Kushte më të mira”, “I besojmë klasës punëtore”, “Duan Republikë”, “Rroftë populli vlla shqiptar”, “Jemi shqiptarë e jo jugosllavë”, “Kosova është e jona”, “Kosova kosovarëve”, “Bashkimi i viseve shqiptare”, “Të dënuarit politikë të kthehen në Kosovë”, “I kërkojmë shokët e burgosur”, “Republikë”, e tjera.

Kah ora 13.30 një grup i konsiderueshëm studentësh tentoi të depërtojë në drejtim të qendrës së qytetit me qëllim që t'i pengonte manifestimet me rastin e pritjes së stafetës së rinisë, por u pengua nga ana e forcave të sigurimit. Ky grup nuk deshë të shpërndahet, e as nuk pranoi biseda në Universitet, por filloi t'i gjuajë forcat e sigurimit me gurë dhe me sende të tjera, duke tentuar ta

shpërthente bllokadën. Një student - demonstrant shtiu me armë zjarri, por nuk e qëlloi askend.

Pas lëshimit të këtyre parullave dhe tërheqjes së aktivistëve tanë, një numër i konsiderueshëm studentësh të tubuar u larguan nga ai tubim, kështu që mbetën nja 400.

Komiteti i Mbrojtjes së përgjithshme Popullore dhe i Vetëmbrojtjes shoqërore të KSA të Kosovës – duke vlerësuar karakterin armiqësor të demonstratave dhe për ta penguar daljen e demonstrantëve në rrugët e qytetit – vendosi që njësia e milicisë, që ishte caktuar më parë, ta përdori gazin lotsjellës, e kjo edhe u zbatua. Në saje të efektit të mjeteve kimike grupi u shpartallua, por më vonë prapë u tubua në një terren më të gjerë të kompleksit të studentëve.

Kah ora 16.30 organizatorët e demonstratave u prinë studentëve të tubuar kah njësia e milicisë, duke i gjuajtur milicionarët me gurë, me qëllim që ta shpërthenin rrethimin dhe të drejtoheshin kah qendra, ku mbaheshin manifestime me rastin e pritjes së stafetës së rinisë. Meqenëse qëndrimi i ynë ishte që demonstrantët të mos lejohen kurrsesi të depërtojnë në rrugët e qytetit, vazhdoi përdorimi më i ashpër i forcës me përdorimin e gazit lotsjellës dhe të pendrakëve nga ana e njërive të milicisë, të cilave - në bazë të marrëveshjes – u ardhni në ndihmë një njësi speciale e Sekretariatit Federativ të Punëve të Brendshme. Me rastin e intervenimit të forcave të sigurimit u lënduan 32 studentë, prej të cilëve 1 rëndë. Pjesa më e madhe e lëndimeve të demonstrantëve u shkaktuan me rastin e tentativave të tyre që t'i kthejnë bombat kimike të dorës. U lënduan 12 pjesëtarë të forcave të sigurimit, 1 prej të cilëve rëndë. Asnjë prej të lënduarve nuk ishte në rrezik jete. Gjatë aksionit të shpërndarjes së demonstratave, demonstrantët shtinë dy herë me revole, por me pasoja. Prej nja 200 pjesëmarrësve të demonstratave të arrestuar përkohësisht 21 u ndalën në paraburgim, ndër të cilët edhe organizatorët e drejtpërdrejtë dhe ata që u ekspozuan në mënyrë më ekstreme.

Pritja e stafetës në Prishtinë, mitingu dhe programi në të cilin morën pjesë afro 40.000 punëtorë, të rinj pionierë dhe qytetarë të tjerë, pjesëtarë të të gjitha kombeve e kombësive, ishte madhështore, kurse organizimin e siguronin kryesisht punëtorët e kolektivave punonjëse, njësitë e vetëmbrojtjes dhe komunistët.

Që nga fillimi i trazirave, në bazë të qëndrimeve të kryesisë së Komitetit Krahinor të LK të Kosovës dhe të Kryesisë së KSA të Kosovës, aksioni dhe masat e drejtpërdrejta për përballimin e gjendjes së krijuar udhëhiqeshin nga komiteti i mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe Vetëmbrojtjes Shoqërore të KSA të Kosovës dhe nga ai i Prishtinës, me organizim të drejtpërdrejtë të organeve dhe të komunistëve të të gjitha fakulteteve e shkollave të larta dhe të udhëheqësve të Lidhjes së Rinisë Socialiste. Komiteti Komunal i LK të Prishtinës caktoi program konkret të aksionit politik në fakultete, në shkolla të

larta, në konvikte dhe në restorantin e studentëve gjatë demonstratave dhe pas shpartallimit të tyre, gjë që dha kontribut që gjatë gjithë kohës të mbahen mësimet në fakultete. Në mbledhjet e partisë në të gjitha fakultetet dhe shkollat e larta demonstratat u vlerësuan si armiqësore, e u caktuan edhe detyrat konkrete në punë me studentët për pengimin e çdo dukurie tjetër dhe aksesi, si dhe në zhvillimin normal të punës dhe të jetës në Universitet.

Gjatë këtyre ngjarjeve Kryesia e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës ishte në kontakt dhe marrëveshje permanente me Kryesinë e KQ të LKJ, të RSF të Jugosllavisë, të RS të Serbisë, të KQ të LK të Serbisë, e njëkohësisht i ka informuar komitetet komunale të Lidhjes së Komunistëve dhe e ka orientuar punën e tyre.

Më 27 mars është mbajtur mbledhja e përbashkët e Komitetit të Mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe të vetëmbrojtjes Shoqërore të KSA të Kosovës dhe e Komitetit të mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe të vetëmbrojtjes Shoqërore të Prishtinës, ku u vlerësuan ngjarjet, aktiviteti dhe masat që ishin ndërmarrë lidhur me këtë. Kryesia e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës dhe Kryesia e KSA të Kosovës, në mbledhjet e veta, bënë kualifikimin politik të këtyre demonstratave. U vlerësuan se këto demonstrata të studentëve kanë karakter armiqësor, e kanë qenë të organizuara nga ana e armikut, se janë pjesë përbërëse e aktivitetit të organizuar të forcave armiqësore për krijimin e trazirave dhe të pastabilitetit në Kosovë, se ngjarjet e mëparshme (demonstratat) në esencë janë pjesë përbërëse e kësaj veprimtarie armiqësore dhe se të gjithë këto në tërësi janë pjesë përbërëse e tendencave armiqësore, të orientuara kah stabilizimi dhe shkatërrimi i Jugosllavisë. Këto demonstrata të studentëve u dënuan në mënyrë të ashpër në Universitet në Prishtinë dhe në të gjitha komunat e krahinës nga ana e pjesëtarëve të të gjitha kombeve e kombësive, kurse u përkrahën plotësisht aksionet dhe masat që janë ndërmarrë për shkatërrimin e tyre. Kjo u shpreh në mënyrën më bindëse me pjesëmarrjen masive dhe me karakterin solemn të manifestimeve me rastin e pritjes dhe të përcjelljes së stafetës së rinisë në shumë vende të Kosovës si dhe me reagimin e rinisë, të punonjësve dhe të qytetarëve kundër aksioneve armiqësore të demonstrantëve dhe me dënimin e tyre të ashpër.

Kryesia e Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës dhe Kryesia e KSA të Kosovës konstatuan se është e domosdoshme që të shpejtohet analizimi i tërësishëm i burimeve, i prapavijës dhe i forcave nga radhët e armiqve të brendshëm e të jashtëm, që qëndrojnë prapa këtyre aksioneve. Njëkohësisht, u konkludua se është e nevojshme të vazhdojë dhe të nxitet zgjidhja efikase e problemeve sociale përgjithësisht e veçmas të disa problemeve sociale të nxënësve dhe të studentëve, rreth të të cilave edhe ashtu është duke punuar, si dhe që - krahas luftës intensive kundër tendencave armiqësore – të vazhdojnë aktivitetet për kryerjen e detyrave të stabilizimit ekonomik. Në këtë mbledhje u bë vlerësimi kritik i shkallës së organizimit dhe

të efikasitetit të veprimit të Lidhjes së Komunistëve në disa ambiente rreth aftësimit dhe vetorganizimit në sferën e mbrojtjes së përgjithshme popullore dhe të vetëmbrojtjes shoqërore.

Më 27 mars u mbajt mbledhja e Komitetit Komunal të LK të Prishtinës, në të cilën u takuan detyrat e drejtpërdrejta për veprim ideopolitik në Universitet dhe në organizatat themelore të Lidhjes së Komunistëve, si dhe në të gjitha organizatat dhe organet e tjera shoqërore-politike.

Po atë ditë u mbajt mbledhja me sekretarët e organizatave themelore të lidhjes së Komunistëve, si dhe mbledhja e Aktivit Politik të Komitetit Komunal. Fill pas kësaj, të gjitha organizatat themelore të LK-së u informuan për karakterin armiqësor të këtyre ngjarjeve, si dhe për vlerësimet e Komitetit Komunal dhe të kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës.

Më 28 mars u mbajt mbledhja e Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve, në të cilën u vlerësua gjendja aktuale politike dhe u aprovua plani konkret i aktivitetit të drejtpërdrejtë. U vlerësua se situata ende është e acaruar. U formuan grupe aktivistësh, të cilët kishin për detyrë t'u ndihmojnë organizatave themelore të Lidhjes së Komunistëve në të gjitha ambientet. Një ditë më vonë (më 29 mars) u mbajtën mbledhje të kolektivave të mësimit në të shkollave të mesme dhe të Universitetit, si dhe mbledhje të organizatave themelore të Lidhjes së Komunistëve në qytet. Komitetet e Mbrojtjes së përgjithshme popullore dhe të vetëmbrojtjes shoqërore në organizatat punonjëse e vlerësuan situatën në ambientin e tyre dhe ndërmorën masa të syçeltësisë. Në të gjitha mbledhjet u përkrah Informata e Kryesisë së Komitetit Krahinor të LK të Kosovës në lidhje me demonstratat. Në mbledhjet, sidomos në disa fakultete një numër mësimit reaguan ndaj gjoja ashpërsisë së masave, që ishin ndërmarrë për pengimin e demonstratave dhe ndaj gjoja tejkalimit të autorizimeve nga ana e organeve të sigurimit. Kjo u vlerësua si tentativë e largimit të vëmendjes prej çështjeve dhe problemeve qenësore.

Më 30 mars në shkolla të larta dhe në fakultete ishin në mësim një numër më i vogël studentësh se zakonisht, kurse u shënuan edhe tentativa të bojkotimit të mësimave me përhapjen e dezinformatave të ndryshme (në Fakultetin Ekonomik, në fakultetin e Shkencave Natyrore dhe në fakultetin Juridik). Po atë ditë u mbajtën mbledhje të organizatave themelore të Lidhjes së Komunistëve në të gjitha fakultetet dhe shkollat e larta – me përjashtim të Fakultetit Filozofik dhe të Fakultetit të Shkencave Natyrore. Në këto mbledhje ishte e dukshme pjesëmarrja e studentëve komunistë, por prapëseprapë me një numër më të vogël se zakonisht.

* * *

Më 30 mars, nja 200 nxënës të Qendrës Shkollore në Obiliq, të cilët duhet të fillonin mësimin në orën 13.00, dolën në rrugën kryesore të Obiliqit duke thyer vitrinat dhe duke lëshuar parulla kryesisht të ngjashme sikurse edhe

demonstrantët në Prishtinë. Pas përdorimit të dy petardava, nxënësit u shpërndanë, por një grup i konsiderueshëm shkoi në drejtim të punishtes “Kosova B”, ku kërkoi mbrojtje nga ana e punëtorëve. Pas bisedës së aktivistëve me nxënësit dhe me punëtorët, nxënësit shkuan në shtëpi të veta. Përndryshe, në Obiliq u ndërmorën masa që më 31 mars të zhvillohet mësimi normal. Një grup bukur i madh aktivistësh shkoi në fshatrat përreth për të biseduar me prindërit. Ky ishte element i ri – që të bëhej eskalacioni i demonstratave edhe jashtë qendrës së studentëve. Ishte posaçërisht i ri edhe fakti se demonstrantët kërkojnë mbrojtje nga ana e punëtorëve.

Më 31 mars situata e përgjithshme në Prishtinë e posaçërisht në Universitet, ende ishte e ngarkuar me elemente të gjendjes së krizës. Bojkotimi i mësimëve në fakultete ishte më i gjerë se gjatë ditëve të mëparshme, me tendencë të përhapjes së vatrave të krizës edhe në shkollat e mesme. Ndihej veprimtaria e armikut për t’i bindur studentët që të mos shkojnë në mësim. Në Fakultetin e Mjekësisë nuk u mbajtën mësimet në gjuhën shqipe. Mësimet në Fakultetin Teknik u mbajtën në një numër të vogël grupesh dhe me një numër tepër të vogël studentësh. Në Fakultetin Juridik u shënuan raste të bojkotimit dhe të ndërprerjes së mësimëve. Në Fakultetin Filozofik një numër tejet i vogël grupesh mësimore mbajtën mësimet. Në Fakultetin e Shkencave Natyrore – megjithëse erdhën një numër studentësh – këta nuk hynë në mësojtore. Mësimet nuk u zhvilluan as në Fakultetin e Bujqësisë, megjithëse në mëngjes kishin ardhur 60-70 studentë. Në të gjitha fakultetet u vërejt mosprezenca e një numri kuadrosh mësimore, megjithëse duhet të ishin në fakultet prej orës 7 e 30 deri në orën 19.00.

Po atë ditë u organizua kujdestaria në të gjitha fakultetet.

Në Qendrën e studentëve u shënuan trazira, kurse rreth orës 11.00 një grup relativisht i madh studentësh në oborrin e konvikteve të studentëve lexuan njëfarë letre, e pastaj u shpërndanë.

Në mbledhjen më 31 mars 1981, Komiteti Komunal i Lidhjes së Komunistëve dhe Komiteti i Mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe i Vetëmbrojtjes Shoqërore, në marrëveshje me organet e mbrojtjes territoriale, urdhëruan që të forcohet sigurimi i objekteve. U organizuan nja dhjetë grupe me nga 30 aktivistë në punktet e ndryshme në qytet. Këto grupe ishin të mobilizuara gjatë gjithë kohës. Përndryshe, edhe më parë – pas 11 e 26 marsit – ishin organizuar kujdestaritë, e ishte urdhëruar aktivizimi i komitetit të mbrojtjes së përgjithshme popullore dhe të vetëmbrojtjes shoqërore dhe vështrimi i planeve të tyre për situatat e krizave në të gjithë ambientet.

* * *

Më 31 mars 1981 ekzistonin indikacione të caktuara se nxënësit e Qendrës Shkollore të Arsimit të mesës të orientuar në Podujevë do ta bojkotojnë mësimin më 1 prill dhe do të organizojnë demonstrata, për çka u informuan faktorët shoqërorë-politikë të Komunës dhe të Krahinës. Megjithëse aktivistët u

përpoqën ta pengojnë bojkotimin e mësimit dhe organizimin e demonstratave, më 1 prill në orët e mëngjesit u tubuan në oborr të Qendrës afro 200 nxënës. Pas një bisede bukur të gjatë me mësimdhënësit dhe me punëtorët shoqërorë-politikë, grupi vendosi të demonstrojë, kështu që kah ora 11.30 u drejtua kah Qendra e qytetit. Grupi ishte tejet agresiv dhe i kumbueshëm dhe thente me gurë vitrinat e shitoreve dhe dritaret e banesave, duke lëshuar parulla me përmbajtje armiqësore.

Në bazë të urdhërit që morën, organet e sigurimit intervenuan me mjete kimike- me gaz lotsjellës kah ora 13.00 kur masa u shpartallua në dy grupe dhe u largua nga Qendra e qytetit. Meqenëse forcat e sigurimit ishin të pakta përkaq numri, demonstrantëve u shkoi përsëri për dore të tubohen në qendër të qytetit. Kur arritën përforcime në orën 16.00 u ndërmor aksioni i dytë i shpërndarjes, kështu që demonstrantët u shpartalluan në disa grupe. Me këtë rast demonstruesit thyen një numër bukur të madh vitrinash të shitoreve, dritaresh në hotelin e ri, në ndërtesën e postës dhe në godinën e fabrikës "Poliester".

Në saje të intervenimit të forcave të sigurimit demonstrantët u shpartalluan.

Në demonstrata në Podujevë u lëndua edhe një milicioner dhe disa demonstratë, tre prej të cilëve bukur rëndë.

* * *

Më 1 prill kah ora 12.30 në Prishtinë shpërthyen demonstrata bukur të gjëra. Një grup nxënësish të shkollës së mesme ekonomike dhe të shkollës bujqësore, e edhe studentësh – nja 100 sish - u nisën nga oborri i shkollës në drejtim të qytetit, duke lëshuar parullën "Republikë". Për ta penguar hyrjen e grupit në qytet, forcat e sigurimit e bllokuan dhe e ndanë në grupe më të vogla. Mirëpo, atëherë iu bashkua nxënësve edhe një numër punëtorësh të ndërtimtarisë, të cilët punonin në objekte në lokalitetin "Dardania", kështu që dy orë më vonë grupi kishte më se 200 vetë. Meqenëse ishte fjala për punëtorët dhe për faktin se këta kalonin të qetë nëpër qytet, forcat e sigurimit nuk intervenuan. Grupi vazhdoi në drejtim të konvikteve të studentëve, e në afërsi të menciës së studentëve filloi skandimin: "Studentë". Pas kësaj grupi u nis nëpër rrugën "Ramiz Sadiku" në drejtim të fakulteteve dhe të qendrës së qytetit. Në ecje e sipër grupit iu bashkuan një numër studentësh, kështu që deri në orën 15 grupi numëronte afro 500 vetë dhe u ndal në udhëkryqin midis Fakultetit Teknik dhe atij Juridik. Një orë më vonë grupit iu bashkua edhe një numër punëtorësh të ndërmarrjeve ndërtimore, të fabrikës së Amortizatorëve dhe të Kombinatit të Obiliqit. Disa prej tyre ishin të armatosur me shkopinj, shufra hekuri, me helmetë, të punëtorëve dhe me gjera të tjera.

Afro 300 punëtorë të Mihjes sipërfaqësore "Bellagovc" u tubuan para ndërtesës së Drejtorisë dhe kërkuan që të bisedojnë me udhëheqësit më të lartë krahinorë. Kuadrot përgjegjës të komunës dhe të Krahinës biseduan me ta afro

1 orë. Ky grup punëtorësh theksonte të njëjtat parulla sikurse edhe demonstrantët. Ndonjë marrëveshje politike me ta as që mund të arrihej, kështu që kuadrot u tërhoqën, por para mbrëmjes edhe grupi u shpërnda spontanisht.

Pas orës 16 demonstrantët në qytet filluan të bëjnë presion kundër forcave të sigurimit duke i gjuajtur me gurë, për ç'arsye pjesëtarët e milicisë - në vetëmbrojtje – përdorën gazin lotsjellës. Pasi e shpërthyen bllokadën, demonstrantët erdhën deri te ndërtesa e Këshillit Ekzekutiv, e pastaj para ndërtesës së Komitetit Krahinor të LK të Kosovës.

Gjatë demonstratave lëshoheshin parullat si u përmendën më parë, por me këtë rast u dëgjuan edhe parullat “Rroftë Adem Demaçi” (irredentist i njohur e i përbetuar, i cili gjendet në burg si i dënuar), kurse para Komitetit Krahinor shkruan në pllata: “Rroftë Adem Demaçi”, “Duam Republikë”, “Kosova Republikë”, “Të lirohen shokët”.

Demonstrantët thyen vitrina të shitoreve, kioska, dritare të banesave, qelqe të veturave dhe të automjeteve të tjera.

Me aksion të forcave të sigurimit dhe ky grup u shpartallua.

Sipas vlerësimit tonë, numri i pjesëtarëve në demonstrata ishte rreth 3.000. Supozojmë se prej këtij numri nja 300 ishin punëtorë. U lënduan 17 punëtorë të milicisë (dy relativisht rëndë) dhe 15 demonstrantë (tre relativisht rëndë). Askush nuk u lëndua prej armëve të zjarrit.

Përkundër masave politike e të tjera që ishin ndërmarrë. Më 2 prill në orët e hershme të mëngjesit vazhduan trazirat në Prishtinë. Kah ora 6.00, një grup punëtorësh të KNI “Ramiz Sadiku” të Prishtinës u tubua para stacionit të autobusëve, të këtij grupi iu bashkuan një numër punëtorësh të Organizatës Punonjës Ndërtimore “Kosova” të Vuçiternës, e pastaj të gjithë u nisën në drejtim të qytetit. Organet e sigurimit i ndalën, e pastaj me përdorimin e mjeteve kimike i shpërndanë në lokalitetin “Dardania” - në drejtim të “Dreçanit”. Pas shpërndarjes së këtij grupi, në disa vende filluan të forcohen grupe më të vogla, në të cilat kishte punëtorë, studentë dhe nxënës, të cilëve pas orës 9.00 iu bashkua edhe një numër punëtorësh “veçarit”, të “PUT-it”, të Fabrikës së Tullave e të tjegullave, nxënësit e Qendrës së Arsimit të orientuar “Xhevdet Doda”, pasi u larguan nga mësimi. Në orët e mëngjesit nxënësit e Qendrës Teknike Shkollore “19 Nëntori” i braktisin mësimet meqenëse mësimdhënësit dhe aktivistët nuk mundën t'i ndalin, kështu që edhe ata u nisën kaq qendra “Milladin Dopoviq”, por rrugës u shpërndanë.

Për të bërë efekt psikologjik në demonstrantët. Komiteti i Mbrojtjes së Përgjithshme Popullore dhe i vetëmbrojtjes shoqërore të KSA të Kosovës vendosi që të defilojnë tankset nëpër qytet.

Rreth orës 10.30 në qytet dhe rreth tijë, në disa vende, grupe agresive bënë presion në drejtim të qendrës së qytetit. Rreth orës 11.00 një grup qytetarësh afër fshatit Devet Jugoviq, bëri presion ndaj forcave të sigurimit, si dhe një grup midis ndërtesës së Kuvendit të Komunës dhe të asaj të Gjyqit të

Qarkut. Në të njëjtën kohë, një grup punëtorësh nga Obiliqi u nisën në drejtim të Prishtinës. Të gjitha grupet e demonstrantëve në Prishtinë vazhduan presione agresive kundër forcave të sigurimit.

Në Obiliqi u tubua një masë e madhe punëtorësh dhe diku ka ora 14.30 bllokoi një njësi të vogël të mbrojtjes territoriale. Kah ora 16.00 ky grup arriti në Prishtinë. Demonstrantët që ecnin në krye të kolonës mbanin një fotografi të shokut Tito, flamurin e Jugosllavisë dhe atë shqiptar, kurse një numër i konsiderueshëm punëtorësh mbanin në duar shkopinj dhe sende të tjera, e disa individë edhe armë zjarri, me të cilat më vonë edhe shtinë. Pas një kohe të shkurtër u nis nga Obiliqi edhe grupi i dytë i punëtorëve, i cili tentoi të hyjë në Prishtinë nëpër lokalitetin "Dragodan", por forcat e sigurimit me përdorimin e mjeteve kimike arritën t'i shpërndajnë pa pasoja.

Midis orës 15.00 e 16.00 u formua përsëri një grup i madh demonstrantësh para ndërtesës e Gjyqit të Qarkut. Demonstrantët erdhën nga drejtimi i Fabrikës së Tullave e tjegullave, duke mbajtur transparente. Këtyre iu bashkua edhe grupi i demonstrantëve i cili gjendej në rrugën më të dalur nga Prishtina në drejtim të Podujevës. Ky grup bëri presion kundër forcave të sigurimit duke i sulmuar me sende të ndryshme me qëllim që ta shpërbente bllokadën dhe t'i afrohej ndërtesës së Këshillit Ekzekutiv.

Pas shpërndarjes së këtyre tri grupeve të mëdha, kah ora 19.00 u formuan edhe disa grupe të vogla në pjesët e ndryshme të qytetit, të cilat u shpartalluan definitivisht rreth orës 20.

Gjatë gjithë kohës grupet e demonstrantëve në pjesët e ndryshme të qytetit kanë demoluar, thyer dhe dëmtuar objektet e ndryshme, kurse në disa pjesë të qyteteve kanë demonstruar dhe kanë shtënë me armë zjarri.

Njëkohësisht (më 2 prill) shpërthyen demonstrata edhe në Podujevë, ku ishin disa qindra pjesëmarrës, në pjesën më të madhe nxënës. Qytetarët bënë barrikada në disa vende nëpër rrugë dhe u bënë rezistencë forcave të sigurimit, të cilat vinin nga drejtimi i Kurshumlisë kah Prishtina, si dhe forcave që u ishin dërguar nga Prishtina forcave të sigurimit në Podujevë, si ndihmë. Pas arritjes së ndihmës me njerëz dhe në mjete kimike, me intovenim u shpartalluan demonstratat.

Përveç Prishtinës e Podujevës, demonstrata u organizuan gjatë 2 prillit edhe në Vuçiternë, në Lipjan dhe në Glllogovc, kurse u bënë tentativa për organizimin e tyre në Gjakovë dhe në Gjilan.

Rreth orës 13.30 një grup prej nja dhjetë punëtorësh të ndërmarrjes ndërtimore "Kosova" të Vuçiternës hyri në një paralele të Qendrës së shkollave të mesme "Muharrem Bekteshi" dhe kërkoi prej nxënësve që ta braktisnin mësimin dhe të dalin në rrugë. Nja 150 nxënës dolën në rrugët e qytetit duke lëshuar parulla me përmbajtje armiqësore. Ky grup kaloi pranë disa organizatave punonjëse me qëllim që t'i bindëte punëtorët për të marrë

pjesë në demonstrata. Mirëpo, meqenëse kurrkush nuk iu bashkua, grupi u shkapërderdh gradualisht, e më në fund edhe u shpërnda.

Në Lipjan, një grup prej 400-500 nxënësish të qendrës së arsimit të mesëm të orientuar depërtoi në qytet kah ora 15.20. Me intervenim të forcave të sigurimit ky grup u përgjysmua, por nja 550 nxënësve përsëri u shkoi për dore të depërtojnë në qytet, ku thyen disa vitrina të dyqaneve, e më parë kishin thyer edhe dritaret e ndërtesës së pompës së benzinës. Gjatë gjithë kohës grupi lëshonte parulla armiqësore, e definitivisht u shpartallua rreth orës 17.00.

Një grup prej nja 30 nxënësish të fazës së dytë të Qendrës së Arsimit të mesëm të Orientuar në Gjilan kah ora 19.15 vrapuan nëpër qytet duke lëshuar parullën "Duam Republikë". Me intervenim të organeve të sigurimit ky grup u shpërnda menjëherë.

Në Gllgovc, kah ora 10.00 nxënësit e dy paraleleve të detashuara të Qendrës së shkollave të mesme të Gllgovcit nga Cikatova u nisën në drejtim të qytetit, ku ju bashkuan një numër i konsiderueshëm nxënësish. Rrugës ata thyen vitrina e dritare të automobilave dhe lëshuan parulla armiqësore. Nxënësve iu bashkua një numër qytetarësh, të cilët kishin qëlluar në pjacë. Disa demonstratë filluan të shtinë me armë zjarri, kështu që me atë rast njeri prej tyre plagosi rëndë një nxënës. Demonstrantët ia rrëmbyen një pjesëtar të forcave të sigurimit pushkën automatike, e cila u gjet më vonë. Me përdorimin e mjeteve kimike, forcat e sigurimit i shpërndanë demonstrantët.

Në Gjakovë nja 50 nxënës e studentë, të strehuar në internatin e shkollave të mesme, kah ora 18.30 u nisën në drejtim të qytetit me qëllim që të demonstrosnin, por u kthyen në oborr të internatit pas intervenimit të aktivistëve shoqërorë-politikë dhe të forcave të sigurimit. Kah ora 19.30 në qendër të qytetit u tubua një grup prej nja 60 studentëve dhe nxënësve të cilët thyen vitrina dhe lëshuan parulla armiqësore. Forcat e sigurimit shpërndanë shumë shpejt grupin, i cili u orvat të organizonte demonstrata.

Në të gjitha vendet e përmendura demonstrantët lëshonin parulla armiqësore, e më së shumti: "Duam Republikë", "Republika", "Rroftë Republika e Kosovës", "Lironi shokët, "Poshtë borxhezia", Trepça punon, Serbia e shfrytëzon", "Rroftë Adem Demaçi".

Në të gjitha vendet ku u organizuan demonstratat, demonstrantët shkaktuan dëme materiale, duke thyer vitrina, duke demoluar ndërtesa dhe duke djegur vetura dhe automjete të tjera etj. Dëmi më i madh material u bë në Prishtinë dhe në Podujevë.

* * *

Në mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së RSF të Jugosllavisë dhe të Kryesisë së Komitetit Qendror të LK të Jugosllavisë, që u mbajt më 2 prill 1981 në Lidhje me situatën në KSA të Kosovës, u mor vendimi për shpalljen e situatës së krizës në territorin e KSA të Kosovës dhe për aplikimin e planit të

situatës së krizës, vendimi për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në territorin e Komunës së Prishtinës dhe vendimi për aplikimin e masave të gatishmërisë.

Në harmoni me këto vendime, Komiteti i Mbrojtjes së Përgjithshme popullore dhe i vetëmbrojtjes shoqërore të KSA të Kosovës urdhëroi aktivizimin e planeve për situatën e krizës. U dha urdhëri për aktivizimin 100% të organizimit të luftës të organeve të punëve të brendshme në KSA të Kosovës. Sekretari krahinor i punëve të brendshme, gjithashtu, lëshoi urdhër për ndalimin e lëvizjes së personave në një numër të madh në vendet publike. Ky urdhër hyri në fuqi muaj më parë.

Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës në mbledhjen që mbajti më 2 prill – mori vendim që, me qëllim të eliminimit të rrethanave të jashtëzakonshme dhe të mbrojtjes prej cenimit të rendit publik, të kufizohet ose të ndalohet lëvizja e njerëzve në vendet e caktuara publike dhe në ato vende në të cilat, me veprimin e individëve apo të grupeve, do të mund të cenohej rendi publik dhe qetësia në një volum të madh ose të rrezikohet rendi publik. Me vendim u urdhërua kufizimi i qëndrimit në vendin e caktuar për ata persona, për të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm se me veprimin e tyre do të mund ta rrezikonin rendin publik. Po atë ditë Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Komunës së Prishtinës urdhëroi që të ndërkrehen mësimet në shkollat fillore, të mesme, të larta dhe në fakultete dhe të mbyllen konviktet e studentëve dhe internatet e rinisë së shkollave të mesme në Prishtinë. Më vonë këtë masë e aplikuan organet krahinore edhe në komunat e tjera në krahinë.

Me kërkesë të udhëheqësish së Krahinës iu dërguan përforcime organeve të punëve të brendshme të KSA të Kosovës nga efektivat e Federatës dhe të të gjitha republikave socialiste dhe të KSA të Vojvodinës, të cilat veprojnë në bazë të urdhërave të kryetarit të kryesisë së KSA të Kosovës.

* * *

Më 3 prill në katër vende në Krahinë (Ferizaj, në Viti, në Vuçiternë dhe në Mitrovicë) shpërthyen demonstrata armiqësore.

Në oborrin e Kombinatit të Drurit në Ferizaj, rreth orës 9.00 u tubua një grup prej nja 200 punëtorëve. Megjithëse aktivistët shoqërorë-politikë u përpoqën t'i qetësojnë, punëtorët ishin këmbëngulës për t'u larguar nga oborri i Kombinatit. Me atë rast lëshuan parulla: "Duam kushte më të mira", "Demobilizonije njësinë e mbrojtjes territoriale të Kombinatit, sepse nuk na duhet", "I duam shokët nga burgu", "Nuk duam tanke në Krahinë", "Duam Republikë", "Nuk duam që të na rrahë fëmijët dhe studentët policia jashtë Krahinës", e të tjera.

Diku kah ora 13.30 një grup prej 100 punëtorëve u larguan nga oborri i Kombinatit dhe shkuan për të bërë demonstrata në qytet. Rrugës iu bashkuan edhe një numër studentësh dhe nxënësish. Në fillim, demonstrantët kalonin të

qetë nëpër qytet, duke brohoritur "Tito, partija". Sa më shumë shtohet grupi, aq më agresiv bëhet. Demonstrantët filluan të lëshojnë edhe parulla me përmbajtje armiqësore. Diku kah ora 15.00 para ndërtesës së Sekretariatit të Punëve të Brendshme disa herë brohoritën "Lëshoni shokët tanë të burgosur".

Ky grup kishte nja 1.000 demonstrantë, kurse forcat e sigurimit e shpërndanë pas orës 15.00 me përdorimin e mjeteve kimike.

Një grup prej nja 200 nxënësish të shkollës së mesme ekonomike tentuan t'u bashkohen demonstrantëve por u penguan dhe u shpërndanë me intervenim të forcave të sigurimit.

Disa demonstratë në Ferizaj shtinë me armë zjarri. Edhe pjesëtarët e forcave të sigurimit, në vetëmbrojtje, përdorën armë zjarri.

Demonstrantët thyen vitrina dhe dritare të automobilave, demoluan disa kioske dhe thyen disa dritare të hotelit "Luboten".

Në Viti, pas orës 10.00 një grua prej nja 100 nxënësve të Qendrës së shkollave të mesme demonstruan nëpër qytet duke lëshuar parullat "Republikë, ma të mirë ose me luftë", "Tito, Partija", "Duam Republikë". Me ndihmën e mësimdhënësve, forcat e sigurimit e shpërndanë grupin. Nuk pati të lënduar. Demonstrantët thyen tri vitrina.

Një grup prej nja 100 vetësh, kryesisht nxënësish u tubuan në periferi të Vuçiternës dhe u nisën në drejtim të qytetit. Megjithëse forcat e sigurimit u përpoqën t'i ndalin, grupi depërtoi, e rrugës iu bashkuan një numër i konsiderueshëm studentësh, nxënësish dhe punëtorësh. Prej organizatës punuese "Polet", ku ju bashkuan nja 30 punëtorë, demonstrantët morën dy fotografi të shokut Tito dhe i bartën në krye të kolonës. Para ndërtesës së Kuvendit të Komunës demonstrantët lëshuan parulla: "Duam Republikës me të mirë ose me luftë", "Lironi shokët prej burgu" etj. Demonstrantët u orvatën pastaj të hyjnë në shkollën e punëve të brendshme, por në saje të intervenimit të forcave të sigurimit – me përdorimin e mjeteve kimike - u penguan dhe u shpërndanë. Në demonstrata merrnin pjesë nja 800 vetë. Gjatë demonstratave, nga ana e demonstrantëve dhe prej disa ndërtesave u përdorën armë zjarri. Edhe forcat e sigurimit përdorën armë zjarri në vetëmbrojtje.

Në Mitrovicë në orën 11.00 një grup prej nja 80 punëtorëve të elektrolizës së zinkut, të punëtorisë së makinave "Fafos" dhe të fabrikës së akumulatorëve dolën në rrugët e qytetit. Këtyre iu bashkuan nxënësit dhe studentët. Një pjesë e grupit hyri në ndërtesë të gjimnazit, ku morën me forcë disa nxënës në radhët e veta. Prej ndërtesës morën një fotografi të shokut Tito dhe e bartën në ballë të kolonës. Demonstrantët u nisën në drejtim të qendrës së qytetit dhe të Qendrës Teknike të shkollave të mesme, duke lëshuar parulla: "Rroftë Partia", "Republikë", "Trepça është e jona", "Trepça punon, Serbia gëzon", "Rroftë klasa punëtore", "Lironi studentët tanë", "Rroftë rinia e Kosovës", "Rroftë republika kosovare", "Republikë, kushtetutë, me të mirë ose me luftë". Edhe në Qendrën teknike të shkollave të mesme, si dhe në ndërtesën e gjimnazit, thyhen

disa dritare dhe detyruan disa nxënës që t'u bashkohen. Vlerësohet se nja 80 për qind të demonstrantëve ishin nga radhët e nxënësve.

Më vonë demonstrantët hynë në oborr të "Trepçës" dhe të "Pafosit", por punëtorët e tjerë iu kundërvunë. Në oborrin e "Pafosit" dhe të Fabrikës së Akumulatorëve, demonstrantët u bërtitnin punëtorëve pse nuk iu bashkuan, si dhe thyen disa dritare të sallave të fabrikave.

Me përqendrim të forcave të sigurimit dhe me përdorimin e mjeteve kimike, demonstrantët u shpartalluan.

Sjelljet e zakonshme agresive të grupeve armiqësore dhe të individëve, sulmet e tyre të hapta kundër organeve të sigurimit shkaktuan disa konflikte. Me këtë rast forcat e sigurimit, sipas udhëzimeve që u janë dhënë, me rastin e intervenimeve për vendosjen e rendit publik dhe të qetësisë së çrregulluar përdorën vetëm mjete kimike dhe pandrekë. Armët e zjarrit u përdorën në disa raste, kur shtihet në ajër me qëllim frikësimi e në dy raste në vetëmbrojtje – në Ferizaj dhe në Vuçiternë – kurse demonstrantët disa herë nuk ngurruan të përdorin armë zjarri.

* * *

Bilanci i të gjitha demonstratave: në anën e demonstrantëve 8 të vrarë dhe 130 të lënduar, prej të cilëve 55 të plagosur me armë zjarri. Në anën e forcave të sigurimit 1 milicionar ka vdekur nga lëndinat, prej pasojave të plagosjes me armë zjarri, kurse janë lënduar 135 milicionarë, 4 prej të cilëve rëndë.

Në të gjitha vendet ku kanë shpërthyer demonstratat janë bërë dëme shumë të mëdha material, të cilat - sipas vlerësimeve tona të para - kapin shumën prej rreth 9 milion dinarësh.

Deri tani organet e sigurimit kanë arrestuar përkohësisht dhe kanë proceduar 956 vetë, janë dënuar për kundravajtje 219 vetë, deri tani janë në procedurë të ndjekjes penale 45 vetë.

